

Raport individual për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligj “Për mbylljen e shoqërive tregtare me kapital shtetëror në likuidim”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Procesi i konsultimit publik është zhvilluar në periudhën 29.01.2026 – 26.02.2026, nëpërmjet Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP). Kohëzgjatja e përgjithshme e konsultimit ishte 21 ditë pune, në përputhje me afatet e përcaktuara në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, i ndryshuar.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

➤ Projektligji i është nënshtruar një procesi konsultimi publik të zhvilluar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.

Metodat e përdorura ishin:

➤ **Konsultimi elektronik (RENJKP):** Projektligji u publikua në Regjistrinë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP), me qëllim informimin e publikut dhe marrjen e komenteve nga grupet e interesit.

➤ **Komunikimi me grupet e interesit:** Gjatë periudhës së konsultimit u administruan komente të përcjella nga Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA), si dhe komente të paraqitura nga individë të interesuar në platformën e konsultimit publik.

Objektivi kryesor i procesit të konsultimit ishte mbledhja e mendimeve dhe rekomandimeve mbi mekanizmat e propozuar për përfundimin e proceseve të likuidimit, trajtimin e detyrimeve, administrimin e aseteve dhe garantimin e sigurisë juridike për palët e interesuara.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Gjatë fazës së konsultimit publik janë administruar komente nga:

- Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA);
- Individë të interesuar dhe aksionarë të shoqërive në likuidim.

Numri i komenteve/rekomandimeve të administruara: 4

Numri i komenteve/rekomandimeve të pranuar: 1

Numri i komenteve/rekomandimeve të pranuar pjesërisht: 3

Përqindja e pranimit: Projektligji regjistroi 669 shikime në RENJKP. Komentet e administruara u shqyrtuan dhe u morën në konsideratë. Disa prej sugjerimeve kontribuuan në sqarimin dhe përforcimin e mëtejshëm të dispozitave të projektligjit, pa ndryshuar thelbin dhe objektivat e variantit të publikuar për konsultim.

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

<p>Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
<p>Garantimi i sigurisë ligjore dhe mbrojtjes së kreditorëve privatë në procesin e mbylljes dhe pasueshmërisë së shoqërive shtetërore</p>	<p>Nga perspektiva e sektorit privat, nisma për të finalizuar procedurat e zgjatura të likuidimit të shoqërive shtetërore dhe për të centralizuar administrimin e aktiveve dhe detyrimeve të tyre kuptohet dhe mirëpritet. Ky hap mund të</p>	<p>Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Sugjerimet e paraqitura nga Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri janë marrë në konsideratë dhe, ndonëse në thelb kanë qenë të parashikuara, janë përforcuar më tej në projektligj, duke garantuar mbrojtjen e kërkesave të kreditorëve privatë, transparencën në verifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve, si dhe</p>

	<p>kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe qartësisë ligjore në menaxhimin e ndërmarrjeve shtetërore.</p> <p>Megjithatë, dëshirojmë të theksojmë rëndësinë e garantimit të sigurisë ligjore dhe trajtimeve të barabarta për kreditorët privatë dhe palët kontraktore. Në veçanti, nënvizojmë këto pika:</p> <p>1. Mbrojtja e Kërkesave të Sektorit Privat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Duhet të sigurohet qartë që transferimi i të drejtave dhe detyrimeve tek shoqëria pasuese shtetërore të mos ndikojë negativisht në zbatueshmërinë e kërkesave legjitime të kreditorëve privatë. • Duhet të ekzistojnë mekanizma që garantojnë se kërkesat ekzistuese ruajnë forcën e tyre ligjore dhe përparësinë. <p>2. Transparenca e Detyrimeve të Papaguara</p> <ul style="list-style-type: none"> • Duhet të vendoset një mekanizëm i qartë dhe transparent për verifikimin, njohjen dhe shlyerjen e detyrimeve kontraktore dhe financiare ndaj subjekteve private. • Publikimi i detyrimeve dhe procedurave të 			<p>vazhdimësinë e marrëdhënieve kontraktore nëpërmjet pasueshmërisë ligjore, me qëllim forcimin e sigurisë juridike dhe trajtimit të barabartë të palëve.</p>
--	---	--	--	---

	<p>shlyerjes do të forcojë besimin dhe llogaridhënien.</p> <p>3. Vazhdimësia e Marrëdhënieve Kontraktore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kur kanë ekzistuar marrëdhënie kontraktore me ish-entitetet, pasueshmëria ligjore duhet të ruajë në mënyrë eksplicite të drejtat kontraktore të palëve private. • Kjo vazhdimësi është thelbësore për të shmangur ndërprerjen e marrëdhënieve të vazhdueshme të biznesit dhe për të mbrojtur besimin e sektorit privat. 			
<p>Statusi i aksionarëve privatë dhe bashkëpronësia</p>	<p>Përfundimi im pas dy komenteve të mësipërme, të cilat nuk shfaqen as si nr komentesh në faqen kryesore. Të metat dhe problematikat kryesore 2.1. Rrezik i lartë për cenim të interesave të kreditorëve Projektligji: • nuk parashikon një procedurë njoftimi publik të kreditorëve, • nuk përcakton afate për paraqitjen e pretendimeve, • nuk garanton mekanizma ankimi për vendimet e transferimit apo fshirjes së detyrimeve. Kjo krijon rrezik që: • kreditorët pasivë ose të painformuar</p>	<p>Fatmira Sykja</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Komenti merret në konsideratë pjesërisht.</p> <p>Projektligji ka adresuar në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë çështjet që lidhen me mbrojtjen e kreditorëve, transparencën dhe garantimin e të drejtave të palëve të treta. Ai parashikon mekanizma konkretë për njoftimin publik, paraqitjen e pretendimeve dhe ushtrimin e të drejtës së ankimit në gjykatë, duke siguruar që asnjë e drejtë ligjore të mos çënohet gjatë procesit të mbylljes dhe transferimit.</p> <p>Njëkohësisht, projektligji garanton që trajtimi i detyrimeve,</p>

	<p>të humbasin të drejtat e tyre, • shteti të përfitojë në mënyrë të njëanshme nga mbyllja administrative e detyrimeve 2.2. Fshirja e detyrimeve të parashkuara – zonë gri juridike Parashikimi për fshirjen e detyrimeve të parashkuara: • nuk shoqërohet me referencë të qartë ndaj afateve të Kodit Civil, • nuk kërkon vendim gjyqësor apo akt administrativ individual. Ekziston rreziku që: • të fshihen detyrime që realisht nuk janë parashkuar, • të krijohen konflikte gjyqësore të mëvonshme me kreditorë 2.3. Fuqi e tepërt e drejtpërdrejtë e Këshillit të Ministrave nëpërmjet këtyre elementëve thelbësorë si: • organizimi, • kompetencat, • financimi, • kapitali fillestar, Këto veprime i lihen vendimeve të Këshillit të Ministrave, pa parime bazë të përcaktuara në ligj. Mungesa e përcaktimit të bazës ligjore ka si pasojë: • dobëson rolin e Kuvendit, • krijon pasiguri normative, • rrit rrezikun e politizimit të shoqërisë së re 2.4. Mbikëqyrje e dobët dhe mungesë kontrolli të pavarur Mbikëqyrja nga ministria përgjegjëse për ekonominë: • nuk përfshin</p>			<p>përfshirë ato të parashkuara, të bëhet në përputhje të plotë me legjislacionin civil në fuqi dhe me radhën e përparësisë së kreditorëve, duke shmangur çdo interpretim arbitrar apo veprim të njëanshëm.</p> <p>Në funksion të rritjes së sigurisë juridike dhe qartësisë në zbatim, këto elemente jo vetëm që janë parashkuar, por edhe janë përforcuar dhe detajuar më tej në dispozitat e projektligjit.</p> <p>Pretendimet se projektligji cënon të drejtat e pronësisë apo mohon bashkëpronësinë nuk qëndrojnë, pasi ai nuk ndërhyr në regjimin e pronësisë dhe nuk zgjidh mosmarrëveshje pronësore, të cilat mbeten objekt i shqyrtimit nga gjykatat kompetente.</p> <p>Projektligji ka një objekt të kufizuar dhe teknik: përmbylljen e proceseve të zgjatura të likuidimit dhe administrimit efikas të aseteve dhe detyrimeve, pa cenuar të drejtat ekzistuese të palëve.</p>
--	--	--	--	--

	<p>Kontrollin e Lartë të Shtetit, • nuk parashikon auditim të detyrueshëm vjetor, • nuk garanton transparencë publike mbi shitjen e asetëve. 2.5. Ndërprerje automatike e kompetencave të likuidatorëve Ndërprerja automatike e kompetencave: • pa proces vlerësimi, • pa përgjegjësi pasuese, • pa mekanizëm verifikimi të veprimeve të kryera, mund të pengojë ndjekjen e përgjegjësive individuale lehtësojë shmangien e llogaridhënies për keqmenaxhim të mëparshëm 3. Çështje që kërkojnë përmirësim ose sqarim • Përcaktim i qartë i procedurës së njoftimit dhe mbrojtjes së kreditorëve • Referencë eksplicite ndaj Kodit Civil për parashkrimin • Përfshirje e auditimit të detyrueshëm nga KLSH • Raportim periodik publik i Operatorit • Kufizim i diskrecionit të VKM-ve për elementë thelbësorë 4. Vlerësim përfundimtar Projektligji në formën e paraqitur favorizon eficiencën administrative mbi garancitë juridike, veçanërisht në kurriz të kreditorëve dhe të transparencës së veprimeve të njëanëshme të shtetit që kanë qëllim</p>			
--	---	--	--	--

	<p>final kalimin e këtyre pronave në favor të interesave të fitimit të bizneseve të paracaktuara.</p> <p>-</p> <p>Pse nuk shpallet edhe për publikun komenti i mësipërm i imi? Edhe sa kohë duhet për t'u aprovuar ky koment? Kush ka të drejtë të censurojë mendimin tim? Atëherë po shtoj, përmbledhtazi, thelbin e komentit tim: ky projektligj është mohim i statusit të bashkëpronësisë. Shteti nuk është pronar i vetëm. Projektligji supozon në mënyrë të rreme se: • shoqëritë janë “me kapital shtetëror”, • shteti është pronar absolut. Në realitet: • një pjesë e konsiderueshme e këtyre SHA-ve janë shoqëri me bashkëpronësi shtet–privat, • shteti zotëron formalisht mbi 51% jo si rezultat i transaksioneve të ligjshme, por: o përmes regjistrimeve të kryera në shkelje të të drejtave të ish-pronarëve të truallit, o pa vendime gjyqësore të formës së prerë. Projektligji legjitimon ex post shkelje të rënda pronësore.</p>			
--	--	--	--	--

<p>Proceset gjyqësore dhe të drejtat pronësore</p>	<p>Ky projektligj nuk merr parasysh fare zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9908 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Ndër të tjera, nuk merren fare parasysh interesat e aksionerëve të tjerë, përkundrazi, trajtohen si inekzistentë. Projektligji nuk shoqërohet me një studim të plotë të gjendjes së vërtetë të këtyre shoqërive ku shteti është bashkëpronar me të tjerë dhe jo pronar i vetëm. Relacioni sqarues që shoqëron projektligjin nuk ka pasqyrim të realitetit mbi këto shoqëri. Relacioni nuk jep asnjë shpjegim që disa prej këtyre SHA-ve, pasqyrohen me zotërim mbi 51 % të përqindjeve të kapitalit prej Ministrisë së Ekonomisë sepse këto përqindje janë aprovuar e janë regjistruar në shkelje të plota ligjore ndaj ish-pronarëve të truallit. Ka shkelje ligjore jo vetëm qysh në krijimin e regjistrimit të tyre, por edhe gjatë gjithë këtyre viteve, deri në momentin e sotëm. Ky reacion nuk jep asnjë shënim mbi arsyet se përse janë këto shoqëri ende të palikuiduara. Ka SHA që kanë si aksionerë në listën e aksionerëve,</p>	<p>Fatmira Sykja</p>	<p>Pranuar pjes</p>	<p>Lidhur me këtë koment sqarojmë se projektligji nuk përfshin në fushën e zbatimit të tij shoqërinë "Duhan Cigare" Shkodër.</p>
--	---	----------------------	---------------------	--

qysh në momentin e regjistrimit fillestar në seksionin tregtar të Gjykatës së Tiranës e pastaj edhe pas mbartjes të këtyre të dhënave në QKB e në QRA, që kanë qenë të vdekur qysh vitet '90. Ka shumë e shumë veprime të tjera në lidhje me pronat e këtyre SHA-ve, ku Ministria na paraqitet me zotërim absolut të kapitalit aksionar, saqë është e pamundur të shkruhen në një kuadrat të tillë.

Mendoj se, sot, këto prona janë objekt lakmie për shumë të tjerë që llobojnë për këtë projektligj të cilit i mungon plotësisht gjithçka dhe vetëm projektligj nuk mund të quhet. Unë jam një ndër aksioneret e ShA "Duhan Cigare" Shkodër, që kam luftuar 14-vite, nga viti 2008 deri në shkurt të vitit 2022, me Ministrinë e Ekonomisë (me emra të ndryshuar ndër vite) për të fituar të drejtat që më/na takojnë, por nuk kam gjetur zgjidhje. Në shkurt të vitit 2022, unë dhe disa prej aksionerëve të tjerë kemi hapur gjyq ndaj Ministrisë së Ekonomisë. Pas betejës së humbur 14-vjeçare, kemi 4 vjet që jemi në proces gjyqësor. Koha e humbur edhe nga gjykatat, tash 4 vite, na sjell sot, pas 18 viteve, në

	<p>këtë moment ku kemi një projektligj, i cili na zhvesh përfundimisht nga çdo e drejtë e jona. Prandaj është thelbësore që këto SHA që kanë procese gjyqësore, nuk duhet të trajtohen me këtë projektligj. Për mosmarrëveshjet e tyre, zgjidhjen duhet ta japë vetëm gjykata. Ky projektligj na zhvesh plotësisht nga e drejta jonë thelbësore: ajo e gëzimit të pronës tonë. E thënë ndryshe, ky projektligj, nën paraqitjen e mbrojtjes së interesit publik, fsheh qëllimin e vërtetë të tij: plaçkitjen e pronave dhe kalimin e tyre për llogari të interesave aspak publike.</p>			
--	---	--	--	--